

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3647
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 08.09.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 43

Datë: 03.09.2025 si dhe projekt-vendimin nr.11 Datë 27.08.2025.

“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË DIBËR PËR VITIN 2025 PËR ALOKIM FONDE PËR INVESTIME PËR OBJEKTIN ”Rehabilitim dhe sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vrenjt (Faza II) ,fshatit Volezë NJA Kastriot dhe i rrugës së Lagjes Murate fshatit Dohoshisht NJA Tomin”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.802/1 prot.

Peshkopi, më 10.09.2025

Lënda: Për vendimin nr.43, datë 03.09.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

BASHKISË DIBËR
KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.43, datë 03.09.2025 **“Për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Dibër për vitin 2025 për alokim fonde për investime për objektin “Rehabilitim dhe sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vrenjt (faza II), fshatit Volezë NJA Kastriot dhe i rrugës së lagjes Murate fshati Dohoshisht NJA Tomin”, vendosa:**

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 43 Datë 03 / 09 /2025

“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË DIBËR PËR VITIN 2025 PËR ALOKIM FONDE PËR INVESTIME PËR OBJEKTIN ”Rehabilitim dhe sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vrenjt (Faza II) ,fshatit Volezë NJA Kastriot dhe i rrugës së Lagjes Murate fshatit Dohoshisht NJA Tomin”.

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 34, 40, 41, 54, 55,
 - Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar,
 - Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010 , “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin „
 - Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
 - Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”
 - Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028 ”
 - Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022 , per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”
 - Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
 - Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore” .
 - Udhëzimin Plotesues Nr. 21 datë 07.07.2023 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”,
 - Udhëzimin Plotesues Nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025”,
- Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **03.09.2025** me 17 vota pro 1 kundër 2 apstenim :

VENDOSI:


Në buxhetin e vitit 2025 të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e regjistrit të investimeve , për vitin 2025 (Tabela nr 1 bashkelidhur).
2. Miratimin e strukturës buxhetore për vitin 2025 (për ndryshimet) sipas tabelës nr 1 bashkelidhur.

3. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Territorit Diber.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Diber.
5. Vendimi u shpall më datë **03.09.2025**.

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mario FEJZA



PROJEKT-V E N D I M

Nr 11 Datë 27/08/2025

PËR NJË NDRYSHIM NE BUXHETIN E BASHKISE DIBER PËR VITIN 2025 PER ALOKIM FONDE PER INVESTIME PER OBJEKTIN

"Rehabilitim dhe sistemim asfaltim I rruges se fshatit Vrenjt (Faza II), fshatit Voleze NJA Kastriot dhe i rruges se Lagjes Murate fshatit Dohoshisht NJA Tomin"

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin",
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore"
- Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028"
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02.2022, për një ndryshim në udhëzimin nr.23 dt 23.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore"
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore".
- Udhëzimin Plotesues Nr. 21 datë 07.07.2023 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin Plotesues Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025",

K E R K O J M E :

Në buxhetin e vitit 2025 të bëhen ndryshimet si më poshte:


1. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e regjistrit të investimeve, për vitin 2025 (Tabela nr 1 bashkelidhur)
2. Miratimin e strukture buxhetore për vitin 2025 (për ndryshimet) sipas tabelës nr 1 bashkelidhur.
3. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Territorit Diber.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Diber

PËR BASHKINË DIBËR:


Drejtör Juridik
Ismet SARACI



Drejtör Ekonomik
Çeljeta ZUNA



Specialiste Buxheti
Erbliua ZUNA


KRYETARI I BASHKISE
Rahim SPAHIU

Në mungesë dhe me porosi
Nënkryetari bashkisë
Lorënc CIBAKU



BASHKIA DIBER
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Finances

Pasqyra e ndryshimeve ne Buxhetin 2025
(Shpenzime kapitale)

Tabela 1


PAKESIMI

Nr.	Pershkrim i shpenzimeve	Objekti i investimit/shpenzimit	Llog	Kapitulli	Kodi projektit	Programi	Ishte	Behet	Vlera e pakesimit	Komente
			Ekon							
1	Shpenzime kapitale	Rikonstruksim i objekteve NJA	231	5	1060454	1110	3,000,000	-	3,000,000	Pakesohet
2	Shpenzime kapitale	Blerje dhe vendosje dyer dritare per objektet arsimore dhe social kulturore	231	5	1060453	9120	2,500,000	-	2,500,000	Pakesohet
3	Shpenzime kapitale	Riparime ne godinat arsimore Bashkia Diber	231	1	1060444	9120	2,000,000	-	2,000,000	Pakesohet
Shuma Totale									7,500,000	
SHTESA										
1	Shpenzime kapitale	Rehabilitim dhe sistemim asfaltim I rruges se fshatit Vrenjt (Faza II) ,fshatit Voleze NJA Kastriot dhe i rruges se Lagjes Murate fshatit Dohoshisht NJA Tomin	231	5	viti 2025	4520	-	5,500,000		Shtohet
1	Shpenzime kapitale	Rehabilitim dhe sistemim asfaltim I rruges se fshatit Vrenjt (Faza II) ,fshatit Voleze NJA Kastriot dhe i rruges se Lagjes Murate fshatit Dohoshisht NJA Tomin	231	1	viti 2025	4520	-	2,000,000		Shtohet
1	Shpenzime kapitale	Rehabilitim dhe sistemim asfaltim I rruges se fshatit Vrenjt (Faza II) ,fshatit Voleze NJA Kastriot dhe i rruges se Lagjes Murate fshatit Dohoshisht NJA Tomin	231	5	viti 2026	4520	-	13,000,000		Shtohet
Shuma Totale								20,500,000	-	

Specialiste Buxhetit
Erblina SELA



Drejtor ekonomik
Çeljeta ZUNA

RELACION

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në mbështetje të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë e vitit 2025", udhëzim nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit " të ndryshuar, në vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr. 5, datë 15.01.2025, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin, nr.31/1 prot. datë 20.01.2025 i ndryshuar Në buxhetin e Bashkisë Dibër për vitin 2025 kërkojmë të bëjmë ndryshime në tabelën e investimeve për vitin 2025 pakësim në zërin Investime sipas tabelës nr 1 bashkëlidhur pakësohet me 7,500,000 lekë diferenca prej 13,000,000 për vitin 2026. Alokimi në buxhetin e vitit 2025 është në vlerën 7,500,000 sipas projektit bashkëngjitur këtij projekt vendimi investimin me objekt "Rehabilitim dhe sistemim asfaltim I rrugës së fshatit Vrenjt (Faza II) ,fshatit Voleze NJA Kastriot dhe i rrugës së Lagjes Murate fshatit Dohoshisht NJA Tomin". Duke qenë se këto projekte i kemi kërkuar për financim nga OJF (Organizata jo fitimprurëse) dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit kërkojmë që të bëhen ndryshimet përkatëse për ti dhënë përparësi zhvillimit të infrastrukturës.

Drejtore Ekonomik
Çeljeta Zuna

